



Në bazë të nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Vendimit të Kuvendit për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena sh.a", Nr. 01.Nr.V-4, dt.27.05.2015, Kuvendi i Komunës së Deçanit me dt.29.12.2015, nxjerrë këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "HIGJIENA SH.A."

I

Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "Higjiena sh. a", në këtë përbërje:

1. Mehmet Osaj,
2. Merita Binakaj,
3. Fatmir Kurmehaj,
4. Bashkim Ramosaj,
5. Dyke Lllolluni.

Komisioni do të zgjedhë Kryesuesin e vet nga radhët e veta, në mbledhjen e parë që do të mbajné.

II.

Të përmendurit në pikën I. të këtij Vendimi do t'a ushtrojnë detyrën e tyre si antarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "Higjiena sh. a" deri në një vendim tjetër të Kuvendit të Komunës, për të cilin do të njoftohet me kohë.

III.

Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës së Deçanit, në përputhje të plotë me Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare

IV.

Kuvendi i komunës ka për detyrë që në afat prej 30 ditësh pas formimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve, të nxjerrë rregulloren e brendshme për përshkrimin e punëve, detyrave dhe obligimeve të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

V.

Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal

01.Nr.XII-3

Deçan, dt.29.12.2015

HYRËSE-LIAZNA-INGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DECANI • DEÇANI MUNICIPALITY	
Nga: Où: From:	K.K. Deçan AS
Nr. Prot: Br. Prot: Prot. No:	3298
Nr. i faqeve: Br. Stranica: No Pages:	01
Data: Datum: Date:	29.12.16



Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj